

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE TIRANE

NR. 1442 REP

NR. 304 KOL / 2



**MARREVESHJE PER TRANSFERIMIN E TITULLIT TE PRONESISE TE KUOTAVE**

Sot, ne Tirane, me 24.04.2018, perpara meje Lorianana A. Robo, noter publik i Dhomes se Noterve Tirane, me adrese ne Tirane, Shqiperi, Rr. "Ismail Qemali", nr. 27/1, u paraqiten personalisht:

**Znj. ANISA SKENDAJ**, shtetase shqiptare, lindur me 17.12.1984, ne Tirane, e bija e Marselit dhe Veres, banuese ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, Tirane, mbajtese e pasaportes nr. SF0069972, madhore dhe me zotesi te plote ligjore per te vepruar (ne cilesine e **Transferuesit**)

dhe

**ORANGE SHPK.**, nje shoqeri e organizuar dhe qe ekziston sipas ligjeve te Republikes se Shqiperise, e regjistruar me Regjistrin Tregtar me numer biznesi K71716006H, dhe me seli te regjistruar ne adresen Rruga Dervish Hima, Nr.1, Ada Tower, Tirane, Shqiperi (ne cilesine e **Perfituesit**), e perfaqesuar nga administratori i shoqerise Z. Marsel Skendaj, shtetas shqiptar, i lindur me 06.11.1949, ne Tepelene, i biri i Zagollit dhe Lushes, banues ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, Tirane, mbajtes i leternjofimit nr. 030336279, madhor dhe me zotesi te plote ligjore per te vepruar.

dhe ortakët e Orange Shpk. si vijon:

- **Gjergj Skendaj**, shtetas shqiptare, lindur me 29.08.1982, ne Tirane, i biri i Marselit dhe Veres, banues ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, Tirane, mbajtes i pasaportes nr. B I0603611, ne cilesine e ortakut zoterues te 1 kuote qe perfaqeson 10% te kapitalit te Shoqerise;

dhe

- **Marsel Skendaj**, shtetas shqiptar, i lindur me 06.11.1949, ne Tepelene, i biri i Zagollit dhe Lushes, banues ne adresen: Rruga Dervish Hima nr. 1, Tirane, mbajtes i leternjofimit nr. 030336279, ne cilesine e ortakut zoterues te 1 kuote qe perfaqeson 90% te kapitalit te Shoqerise.

Une, Noteri Publik, pasi studiova dokumentacionin e paraqitur personalisht prej Paleve apo prej perfaqesuesve te tyre, vertetoj se perfaqesuesit e Paleve jane ne moshe madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar. Me vullnetin e tyre te lire, Palet kane kerkuar dhe lidhin kete akt ("**Marreveshja**") ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise, sipas kushteve dhe afateve te meposhtme:

**MEQENESE**

- A. Me date 24.04.2018, asambleja e ortakeve te Perfituesit ka vendosur zmadhimin e kapitalit te Perfituesit ne shumen 345.000 Leke nepermjet 1 kuote te re me vlere nominale 345.000 Leke qe perfaqeson 9% te kapitalit te Perfituesit dhe me nje prim kapitali ("Kuota e Re").

1

B. Asambleja e ortakeve ka ftuar Transferuesin qe te nenshkruaje dhe shlyeje Kuoten e Re.

C. Transferuesi deshiron te nenshkruaje dhe shlyeje Kuoten e Re, si pasoje e zmadhimit te kapitalit te Perfituesit nepermjet transferimit te titullit te pronesisë mbi: (a) pjeset e kapitalit qe zoteron Transferuesi ne shoqerine DIGICOM Shpk., nje shoqeri e organizuar dhe qe ekziston sipas ligjeve te Republikës se Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me numer biznesi L42018012R dhe me seli te regjistruar ne adresen Rruga Dervish Hima, Nr.1, Ada Tower, Tirane, Shqiperi (me poshte e quajtur “**Shoqeria Digicom**”), qe perfaqesojne 40% te kapitalit te Shoqerise Digicom (“**Kuota Digicom**”), (b) pjeset e kapitalit qe zoteron Transferuesi ne shoqerine INFO-Telecom Shpk., nje shoqeri e organizuar dhe qe ekziston sipas ligjeve te Republikës se Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me numer biznesi K92402002P, dhe me seli te regjistruar ne adresen Rruga Dervish Hima, Nr.1, Ada Tower, Tirane, Shqiperi (me poshte e quajtur “**Shoqeria Info-Telecom**”), qe perfaqesojne 60% te kapitalit te Shoqerise Info-Telecom (“**Kuota Info-Telecom**”), (c) pjeset e kapitalit te shoqerise Professional Marketing Albania Shpk., nje shoqeri e organizuar dhe qe ekziston sipas ligjeve te Republikës se Shqipërisë, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar me numer biznesi L12205034I dhe me seli te regjistruar ne adresen Rruga Dervish Hima, Nr.1, Ada Tower, Tirane, Shqiperi (me poshte e quajtur “**Shoqeria Promarketing**”), qe perfaqesojne 30% te kapitalit te Shoqerise Promarketing (“**Kuota Promarketing**”).

**Sa me lart, dhe ne baze te nenit 73.1 te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” Palet bien dakord si vijon:**

1. Nepermjet kesaj Marreveshje palet bien dakord per nenshkrimin dhe shlyerjen e Kuotes se Re nepermjet transferimit te titullit te pronesisë mbi Kuotat Info-Telecom, Kuotat Digicom dhe Kuotat Promarketing tek Perfituesi ne zbatim te vendimit te asamblese se ortakeve te Perfituesit te dates 24.04.2018.
2. Transferuesi nenshkruan Kuoten e Re qe perfaqeson 9% te kapitalit te Perfituesit dhe bie dakord qe te shlyeje Kuoten e Re dhe primin e kapitalit te caktuar nga ortaket e Perfituesit nepermjet transferimit (shkembimit) te titullit te pronesisë mbi Kuotat Info-Telecom, Kuotat Digicom dhe Kuotat Promarketing nga Transferuesi tek Perfituesi.
3. Perfituesi pranon transferimin e titullit te pronesisë mbi Kuotat Info-Telecom, Kuotat Digicom dhe Kuotat Promarketing ne kembim te titullit te pronesisë se Transferuesit mbi Kuoten e Re.
4. Si pasoje, Perfituesi fiton titullin e pronesisë te Kuotave Info-Telecom, Kuotave Digicom dhe Kuotave Promarketing dhe pronesia mbi keto Kuota kalon nga Transferuesi tek Perfituesi me nenshkrimin e kesaj Marreveshje.
5. Perfituesi do te paguaje te gjitha taksat e dokumenteve dhe regjistrimit, te tashme dhe/ose te ardhshme, per hartimin dhe/ose regjistrimin e kesaj Marreveshje.
6. Palet bien dakord qe Perfituesi ka te drejte te disponoje Kuotat e lartpermendura dhe t’ia shese paleve te treta ne çdo moment pas nenshkrimin te kesaj Marreveshje.
7. Transferuesi deklaron dhe garanton Perfituesin se: (i) Transferuesi eshte pronar i ligjshem dhe i vetem i Kuotave Digicom, Kuotave Info-Telecom, Kuotave Promarketing; (ii) Kuotat Digicom, Kuotat Info-Telecom, Kuotat Promarketing jane te lira nga pengu dhe/ose barra

siguruese ne favor te te treteve; (iii) kjo Marreveshje perben detyrim ligjor, te vlefshem, te detyrueshem dhe te ekzekutueshem ndaj Transferuesit.

8. Perfituesi deklaron dhe garanton se: (i) Perfituesi nuk ka asnje pengim ligjor qe te lidhe kete Kontrate dhe eshte i afte te permbush te gjitha detyrimet qe rrjedhin per Perfituesin prej kesaj Marreveshje; (ii) kjo Marreveshje perben detyrim te ligjishem dhe te ekzekutueshem ndaj Perfituesit dhe çdo pasuesi te tij ne perputhje me kushtet e parashikuara ne te; (iii) Perfituesi eshte njohur me gjendjen financiare dhe statutin e Shoqerive Info-Telecom, Digicom dhe Promarketing dhe nuk ka asnje pretendim te tashem dhe/ose te ardhshem ndaj Transferuesit ne lidhje me objektin e kesaj Marreveshje dhe nese ne te ardhmen do te rezultojte ndonje ndryshim negativ me natyre financiare apo i çfaredo natyre tjeter ne gjendjen e Shoqerive Digicom, Info-Telecom dhe Promarketing qe e ka origjinen perpara dates apo ne daten e kesaj Marreveshje, Perfituesi nuk do te kerkoje nga Transferuesi kthimin e Kuotes se Re, ose ndonje pergjegjesi tjeter te çfaredo natyre.
9. Per çeshtjet te cilat nuk jane parashikuar ne kete Marreveshje apo qe mund te rrjedhin prej saj do te zbatohet legjislacioni perkates ne fuqi ne Republiken e Shqiperise i cili eshte ligji i zbatueshem per kete Marreveshje.
10. Çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis paleve te kesaj Marreveshje ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e kesaj Marreveshje, nese nuk zgjidhet ne mirekuptim mes vete paleve, do te zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, vendimet e se ciles jane te ankimueshme sipas dispozitave te Kodit te Procedures Civile te Republikes se Shqiperise.
- 5.1 Kjo Marreveshje pergatitet dhe nenshkruhet ne 5 kopje ne gjuhen shqipe. Asnje ndryshim i kesaj Marreveshje nuk do te jete i vlefshem nese nuk behet me shkrim dhe nenshkruhet nga secila pale ose perfaqesues te autorizuar rregullisht nga secila pale.

*Une, noteri publik pasi ia lexova me ze te larte paleve te pranishme kete Kontrate te hartuar ne 5 (pese) kopje ne gjuhen shqipe, u binda se palet e konsiderojne kete Kontrate ne perputhje me vullnetin e tyre te lire dhe une vertetoj nenshkrimin e tyre ne perputhje me ligjin.*

**Transferuesi**

Znj. Anisa Skendaj

**Perfituesi**

Orange Shpk.

Perfaqesuar nga administratori Z. Marsel Skendaj

**Ortakët e Perfituesit**

Marsel Skendaj

Gjergj Skendaj



NOTERI

